



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 145, date 11.2.2009

PER

**TRANSFERIMIN E PAKETES SE AKSIONEVE TE ZOTERURA NGA SHTETI NE
"ALBTELECOM", SHA-NE, TIRANE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes, të neneve 9 e 13 të Ligjit Nr. 8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", dhe të neneve 1 e 2, pika 4, të Ligjit Nr. 8810, datë 17.05.2001 "Për percaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom", me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Transferimin e paketës së aksioneve të zotëruara nga shteti, prej 16,7683661 përqindesh, të "Albtelecom", sha-ja, Tirane, nëpërmjet ankandit.
2. Ky transferim të realizohet me asistencën e një shoqërie këshilluese ndërkombëtare.
3. Shpenzimet në vlerën prej 30 000 000 (tridhjetë milion) leke, për realizimin e procedurave të përzgjedhjes së konsulentit, për shërbimet, që do të kryejë konsulenti, si dhe për shpenzime të tjera, të nevojshme për realizimin e transferimit të paketës, të mbulohen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, deri në përfundim të procesit të shitjes.
4. Pas përfundimit të procesit të shitjes, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës t'i rimbursohen shpenzimet e përmendura në pikën 3, të këtij vendimi, nga të ardhurat e realizuara nga shitja e paketës së aksioneve shtetërore, sipas raportit financiar të paraqitur nga kjo ministri.
5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletorën Zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

SALI BERISHA